



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i Informatikës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, (FSHN) shpall konkurs për 10 (dhjetë) personel akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2024 – 2025, sipas kategorive, konkretisht:

- 1 (një) kandidat të kategorisë profesor
- 1 (një) kandidat të kategorisë lektor
- 8 (tetë) kandidat të kategorisë asistentlektor.

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatëve për secilën kategori janë si më poshtë:

I. Kriteret e përgjithshme e të veçanta për personelin akademik të kategorisë *profesor* janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të mbajnë të paktën titullin shkencor “Profesor”. Titulli i lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse e për Arsimin në Shqipëri,
2. Kandidati të ketë përfunduar studimet Universitare në fushën e Shkencave Inxhinieri Kompjuterësh, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softëare dhe Shkenca Kompjuterike apo programe studimi të përafërta me to.
3. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna,
4. Kandidati të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata,
5. Përzgjedhja e kandidatit do të bëhet në përputhje me fushën e tij të studimit.

II. Kriteria të përgjithshme e të veçanta të kategorisë lektor.

II.1 Kriteret të përgjithshme për kandidatët e kategorisë *lektor* janë si më poshtë:

1. Kandidati duhet të ketë gradën Doktor në fushën e Shkencave Inxhinieri Kompjuterësh, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softëare dhe Shkenca Kompjuterike apo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

programe studimi të përafërta me to. Grada e fituar jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.

2. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të, brenda ose jashtë vendit në fushën e Shkencave Inxhinieri Kompjuterësh, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softëare dhe Shkenca Kompjuterike apo programe studimi të përafërta me to, me notë mesatare të studimeve mbi 8. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS;
3. Kandidati duhet të ketë të paktën 2(dy) vite punë mësimdhënie në IAL;
4. Kandidati duhet të njohë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore;
5. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna;
6. Kandidati të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
7. Të jetë i aftë për punë.

II.2. Kriteret të veçanta për kandidatin e kategorisë *lektor* janë si më poshtë:

1. Kandidati të ketë përvojë punë/specializime në fushat e Shkencave Inxhinieri Kompjuterësh, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Software dhe Shkenca Kompjuterike apo programe studimi të përafërta me to
2. Preferohet të jetë i përfshirë në kumtesa/botime shkencore në organe kombëtare/ndërkombëtare në fushat e kërkuar;
3. Të ketë aftësi të mira komunikuese e të punës në grup.

III. Kriteret të përgjithshme e të veçanta për kandidatët e kategorisë *asistentlektor* janë si më poshtë:

III.1 Kriteret të përgjithshme për kandidatët e kategorisë *asistentlektor* janë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

1. Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet universitare Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të, brenda ose jashtë vendit në fushën e Shkencave Inxhinieri Kompjuterësh, Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softëare dhe Shkenca Kompjuterike apo programe studimi të përafërta me to, me notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave mbi 8. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga MAS.
2. Kandidati duhet të njohë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore.
3. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
4. Kandidati të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
5. Të jetë i aftë për punë.

III.2. Kriteret të veçanta për kandidatët e kategorisë *asistentlektor* janë si më poshtë:

1. Preferohet të ketë përvojë në profesion;
2. Preferohet të jetë i përfshirë në botime shkencore në organe kombëtare/ndërkombëtare në fushën e kërkuar;
3. Preferohet të ketë përvojë mësimdhënie në IAL;

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).
3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

5. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).
7. Raport i aftësisë për punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetsore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (06.02.2025 - 17.02.2025) nga data e shpalljes në www.unie.edu.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *personel akademik, Informatika*
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë. Kandidatët konkures do të njoftohen elektronikisht nga Komisioni për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës.